

URDHËR
Nr. 108, datë 16.7.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; dhe udhëzimin nr. 4, datë 29.1.2020, “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit për nisjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit për blerjet me vlerë të vogël apo direkte, si dhe nënshkrimin e kontratave për ushtrimin e aktiviteteve të AZHT-së te drejtori i Drejtorisë së Monitorimit në Territor, z. Saimir Lita.

2. Kompetenca e deleguar, sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri deri më datë 31.12.2026.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri drejtori i Drejtorisë së Monitorimit në Territor, z. Saimir Lita.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Adelajda Roka